



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISË



Programi: **Master**

Drejtimi: **Histori**

**Lënda: HISTORIA E SHQIPËRISË (STUDIME TË ORIENTUARA)
(PJ. III, RILINDJA KOMBËTARE)**

<i>Pedagogu:</i>	Prof. Dr. Ferit Duka
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (15 javë 2 leksione 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	Lëndë me zgjedhje
<i>Viti/Semestri:</i>	II/I

Përshkrimi: Gjatë zhvillimit të kursit do të trajtohen çështje që lidhen me historinë shqiptare të fazës së fundit të periudhës osmane, fazë, e cila njihet ndryshe si *Rilindja Kombëtare Shqiptare* dhe rrok harkun kohor nga vitet 40 të shek. XIX deri në vitin 1912. Në fokus do të jenë sidomos reformat e Perandorisë Osmane (Tanzimati) dhe shqiptarët, përmbajtja dhe tiparet e Rilindjes, zhvillimi i nacionalizmit shqiptar dhe programi i tij politik, vendi dhe roli i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në luftën dhe përpjekjet e shqiptarëve për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë dhe krijimin e shtetit kombëtar të pavarur, si dhe ngjarjet, proceset dhe dukuritë dhe rrethanat që përgatitën shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Nëpërmjet leksioneve dhe seminareve, do të synohet që studentët, jo vetëm të zgjerojnë e të thellojnë njohuritë e fituara për koncepte, kategori, ngjarje dhe procese historike që zhvillohen brenda periudhës së lartpërmendur, por edhe të nxiten dhe të aftësohen më tej për diskutime, analiza dhe kërkime të pavarura rreth tematikës që do të shtjellohet në suazat e këtij kursi.

Temat e leksioneve:

1. Reformat osmane (Tanzimati) dhe shqiptarët.
2. Fillimet e Rilindjes Kombëtare. Përmbajtja dhe tiparet kryesore të Rilindjes.
3. Zhvillimet në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare: ndërthurja e aspekteve kulturore dhe politike.
4. Përpjekjet e rilindasve për të jetësuar programin politik kombëtar: Lidhja Shqiptare e Prizrenit (vitet 1878-1881).
5. Riaktivizimi i projektit politik kombëtar: Lidhja Shqiptare e Pejës (1899).
6. Lëvizja Kombëtare Shqiptare me taktika dhe strategji të reja: Komitetet për Lirinë e Shqipërisë dhe çetat patriotike.
7. Revolucioni i Turqve të Rinj dhe shqiptarët. Avancimi i përpjekjeve për arsimin dhe shkollën shqipe: Kongresi i Manastirit. Kongreset e Dibrës dhe Elbasanit.

8. Diaspora shqiptare dhe Lëvizja Kombëtare.
9. Shqiptarët, faktor i fuqishëm i luftës çlirimtare në Ballkan: kryengritjet kundërosmane të viteve 1910-1912. Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë.
10. Këndvështrime rreth nacionalizmit shqiptar në veprën *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane* të autores Nuray Bozborë.
11. Lidhja e Prizrenit në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro-osmane: një analizë krahasuese bazuar në veprat me këtë tematikë të autorëve Kristo Frashëri dhe George Gawrych.
12. Vendi i Kosovës në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare (sipas veprës *Kosova: një histori e shkurtër* të studiuesit Noel Malcolm).
13. Shoqëria dhe ekonomia në hapsirën shqiptare sipas veprës *Shekujt osman në hapsirën shqiptare* të autorit Ferit Duka.
14. Bota shqiptare si hapsirë kufitare ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit sipas veprës *Shqiptarët* të autorit Oliver Jens Schmitt.
15. Moderniteti dhe hapsira shqiptare në kohën e Rilindjes sipas veprës *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar* të autores Nathalie Clayer.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI: 70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times Neë Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. Belegu, Xhafer. *Lidhja e Prizrenit dhe veprimet e saj (1878-1881)*. (Tiranë: 1939).
2. Bozborë, Nuray. *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*. (Tiranë: Dituria, 2002).

Literatura plotësuese:

3. Clayer, Nathalie. *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*. (Tiranë: Përpjekja, 2009).
4. Duka, Ferit. *Shekujt osmanë në hapsirën shqiptare*. (Tiranë: UET Press, 2010).
5. Frashëri, Kristo. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881)*. (Tiranë: Toena, 1997).
6. Gawrych, George. *Gjysmëhëna dhe shqiponja*. (Tiranë: Bota shqiptare, 2007).
7. Jacques, Edwin. *Shqiptarët: historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*. (Tiranë: Kartë e pendë, 1995).
8. Malcolm, Noel. *Kosova: një histori e shkurtër*. (Tiranë: ShLK, 2001).
9. Schmitt, Oliver Jens. *Shqiptarët. Një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*. (Tiranë: K&B, 2012).

10. Skëndi, Stavro. *Zgjimi kombëtar shqiptar*. (Tiranë: Phoenix, 2000).
11. Swire, Joseph. *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*. (Tiranë: Dituria, 2005).
12. Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, (Tiranë: Phoenix, 1998).

MIRATOI

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Asoc. Dr. Eva TAFILI

Tiranë, 2016